



## Analizë e Projektligjit për Eficiencën e Energjisë

---



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

---

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	4
Elementet kryesore të legjislacionit në fushën e efijencës së energjisë .....	5
Produktet energjetiko-efijente.....	5
Ndërtesat.....	6
Financimi i efijencës së energjisë .....	6
Bashkëprodhimi dhe kogjenerimi.....	6
Transporti .....	7
Ngrohja dhe ftohja .....	7
Projektligji i propozuar.....	8
Amendamentet e Komisionit.....	12
Përfundime.....	13

## Hyrje

Energjia dhe burimet e mjaftueshme të energjisë përbëjnë një nga sfidat dhe synimet më të mëdha të vendeve në zhvillim. Mungesa e burimeve të mjaftueshme dhe kapitalit për të i shfrytëzuar ato, ka ngritur nevojën për shfrytëzim sa më eficient të sasisë ekzistuese të energjisë. Shqetësime janë ngritur edhe në raport me sasinë e dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>), të emetuar në atmosferë dhe eficientia e energjisë shihet si një medotë e mirë për të reduktuar shfrytëzimin e energjisë e rrjedhimisht edhe prodhimin e pakontrolluar.

Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare përmes marrëveshjeve të brendshme, traktaveve dhe dokumenteve të tjera kanë bërë hapa në drejtim të uljes së nivelit të konsumit final të energjisë. Protokoli i Kyotos i vitit 1998, konventa ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike, përcakton që çdo shtet duhet të ndërmarrë masa për të rritur eficientën e energjisë në nivelin kombëtar.<sup>1</sup> Si rezultat, masa në drejtim të përmbushjes së këtyre objektivave për eficientëne energjisë kanë filluar nëpërmasa globale.

Eficientia e energjisë është një fushë e gjerë dhe një objektiv jo i lehtë. Ajo në kuptimin e përgjithshëm nënkupton uljen e konsumit të energjisë në një territor të caktuar. Që nga baza ligjore, gjendja teknike e rrjetit e deri tek sjellja e konsumatorëve, eficientia është rrjedhojë e shumë faktorëve. Në kuptimin ekonomik eficientia e energjisë nënkupton të gjitha veprimet dhe aktivitetet që rezultojnë me uljen e sasisë së energjisë të nevojshme për të prodhuar një njësi të aktivitetit ekonomik.<sup>2</sup> Sasia e konsumuar e energjisë në vit në krahasim me nivelin e GDP-së vjetore për kokë banori, merret si tregues i nivelit të eficientës së energjisë.

Masa të shumta ndërrmeren në drejtim të rritjes së eficientës së energjisë. Investimet në aspektin teknik, informimi dhe vetëdijësimi në këtë fushë janë pikat kryesore. Investimet teknike në funksion të prodhimit dhe transmisionit eficient të energjisë janë të një rëndësie të madhe në një kohë kur shumë shtete humbasin sasi të mëdha të energjisë gjatë procesit të distribuimit. Banka Botërore disponon tabelen me të dhënat mbi humbjet e energjisë në rrjetin e transmisionit, për shtete të ndryshme dhe ndonëse trendet janë në rënie, prap se prap humbjet gjatë transmisionit janë të mëdha. Siç do të shohim edhe Kosova nuk përbën përjashtim në këtë aspekt.

Republika e Kosovës është palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë njëri nga qëllimet e themelimit të së cilit ka qenë pikërisht që të “përmirësohet situata mjedisore në lidhje me Energjinë e Rrjetit dhe eficientën e energjisë, nxitet përdorimi i energjisë së ripërtrishme, dhe të përcaktohen kushtet për tregtinë e energjisë në një hapësirë të vetme rregulluese”<sup>3</sup> Ky përcaktim është reflektuar edhe më tej në aktet e tjera që ka miratuar Komuniteti i Energjisë dhe në të cilat Kosova ka luajtur rolin e saj mbështetës dhe implementues.

---

<sup>1</sup>United Nations, *Kyoto protocol to the United Nations framework convention on climate change*, 1998, <http://unfccc.int/resource/docs/convkp/kpeng.pdf>

<sup>2</sup>World Energy Council, *Energy Efficiency: A Recipe for Success*, 2010

<sup>3</sup>Traktati i Komunitetit të Energjisë, (2005), Neni 2, përkthim jozyrtar i MZHE-së, Prishtinë, i qasshëm në [https://mzhe-ks.net/repository/docs/traktati\\_per\\_komunitetin\\_e\\_energjise.pdf](https://mzhe-ks.net/repository/docs/traktati_per_komunitetin_e_energjise.pdf) (qasur në shtator, 2018).

Që nga viti 2015, Kosova ka marrëdhënje kontraktuale me Bashkimin Evropian. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ishte hapi i parë në garantimin në praktikë të perspektivës evropiane për Kosovën.

Bashkëpunimi mund të përfshijë ndihmën për Kosovën në veçanti sa i përket:

...b) ndihmës për Kosovën që të zbatojë acquis të BE-së për efikasitetin e energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë si dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë, duke nxitur kështu kursimin e energjisë, efikasitetin e energjisë, energjinë e ripërtëritshme si dhe hulumtimin dhe zbutjen e ndikimit mjedisor nga prodhimi i energjisë dhe konsumi;<sup>4</sup>

Baza ligjore me të cilën Kosova është përpjekur të rregulloj fushën e efikasitetit të energjisë ka filluar me Ligjin për Energjinë vitin 2004. Edhe Ligji për Efikasitetin e Energjisë ka tentuar të definoi në mënyrë më specifike rolin dhe kompetencat e institucioneve si dhe ka qenë i rëndësishëm në krijimin e bazës institucionale. Për më tepër, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka hartuar raportin e monitorimit të implementimit të këtij ligji, që do të i ndihmojë zhvillimit të kësaj analize. Planet, strategjitë, udhëzimet apo rregulloret e ndryshme kanë pasur po ashtu rëndësi në kompletimin e bazës ligjore. Të gjitha dokumentet zyrtare janë munduar të përmbushin kërkesat e dala nga direktivat e BE-së mbi Efikasitetin e Energjisë.

Ky punim synon të vë në dukje sfidat e Kosovës në fushën e efikasitetit të energjisë dhe të jepë rekomandime konkrete për përmirësimin e Projektligjit të Propozuar për Efikasitetin e Energjisë.

## **Elementet kryesore të legjislacionit në fushën e efikasitetit të energjisë**

Në Bashkimin Evropian një numër elementesh janë përfshirë në hartimin e legjislacionit në fushën e efikasitetit të energjisë. Ndër elementet kryesore që legjislacioni evropian ka përfshirë janë:

- Produktet energjetiko-eficiente
- Ndërtesat
- Financimi i efikasitetit të energjisë
- Bashkëprodhimi dhe kogjenerimi
- Transporti dhe
- Ngrohja dhe ftohja

Të gjitha këto elemente duhet të përfshihen në mënyrë që efikasiteti i energjisë të ketë trajtim të duhur nga aspekti legjislativ.

### **Produktet energjetiko-eficiente**

Në BE, shumë produktet mbajnë etiketa të energjisë dhe janë projektuar për të përmbushur standardet minimale të efikasitetit të energjisë, si rezultat i këtyre etiketave dhe standardeve do të

---

<sup>4</sup> Republika e Kosovës, (2015), Ligji Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, Neni 114, Energjia, Prishtinë: GZRKS, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239> (qasur në shtator, 2018)

jetë një kursim vjetor i energjisë prej rreth 175 Mtoe (milion ton ekuivalente të naftës) deri në vitin 2020.

### **Ndërtesat**

Direktiva (2018/844 / BE) e Performancës së Energjisë së Ndërtesave, kërkon përsheptimin e rinovimit me kosto efektive të ndërtesave ekzistuese, me vizionin e një stoku të ndërtimit të dekarbonizuar deri në vitin 2050 dhe mobilizimin e investimeve, si dhe mbështet instalimin e infrastrukturës së elektromobilitetit në parqet e makinave të ndërtesave dhe paraqet dispozita të reja për të rritur teknologjitë e zgjuara dhe sistemet e ndërtimit teknik.

Nënelementet kryesore që përfshihen:

- Shtëpitë me konsum afër-zero
- Lëshimi i certifikatave të performancës energjetike
- Krijimi i skemave të inspektimit
- Vendosja e kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat e reja
- Hartimi i listave të masave financiare kombëtare për të përmirësuar eficiencën e energjisë

### **Financimi i eficiencës së energjisë**

BE ka rritur sasinë e fondeve publike në dispozicion për eficiencën e energjisë. Megjithatë, për të përmbushur objektivat e BE dhe për të mbështetur tranzicionin në një sistem të pastër të energjisë, ekziston nevoja për të zhbllokuar më tej financimin privat, veçanërisht për investimet e eficiencës së energjisë. Është vlerësuar se 177 miliardë shtesë në vit do të jenë të nevojshme gjatë periudhës 2021-2030 për të arritur objektivat e BE-së për energjinë.

Nënelementet kryesore që përfshihen:

- Ngrohje ose instalim elektrik me një hyrje totale termike që tejkalon 20MW
- Instalim industrial që gjeneron nxehtësinë e mbeturinave me një input total termik +20MW
- Rrjet ngrohjeje dhe ftohjeje që tejkalon një hyrje të përgjithshme termike prej 20MW
- Përfshirjet: Objektet që pritet të operojnë për më pak se 1500 orë në vit gjatë një periudhe pesëvjeçare, Instalimet e energjisë bërthamore, Instalime të vendosura pranë një lokacioni gjeologjik për kapjen dhe ruajtjen e karbonit
- Qeveritë e BE-së duhet të njoftojnë Komisionin Evropian për këto përjashtime

### **Bashkëprodhimi dhe kogjenerimi**

Direktiva e Eficiencës së Energjisë kërkon që secili vend i BE të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të potencialit kombëtar të kogjenerimit dhe ngrohjes qendrore dhe ftohjes (një shfrytëzues kryesor i bashkëprodhimit) deri në dhjetor 2015.

- Ngrohje ose instalim elektrik me një hyrje totale termike që tejkalon 20MW

- Instalim industrial që gjeneron nxehtësinë e mbeturinave me një input total termik +20MW
- Rrjet ngrohjeje dhe ftohjeje që tejkalon një hyrje të përgjithshme termike prej 20MW
- Përjashtimet: Objektet që pritet të operojnë për më pak se 1500 orë në vit gjatë një periudhe pesëvjeçare, Instalimet e energjisë bërthamore, Instalime të vendosura pranë një lokacioni gjeologjik për kapjen dhe ruajtjen e karbonit
- Qeveritë e BE-së duhet të njoftojnë Komisionin Evropian për këto përjashtime

## **Transporti**

Automjetet me më pak ndotje dhe ato me efikasitet të energjisë luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të politikës së BE-së për reduktimin e konsumit të energjisë, emisioneve të CO<sub>2</sub> dhe emetimeve të ndotësve.

Direktiva për Promovimin e Automjeteve të Pastra dhe Efiçiente të Transportit Rrugor mëton rritjen e tregut të automjeteve ekologjike. Ajo trajton blerjet e automjeteve për shërbime të transportit publik.

Sistemet e Transportit të Pastër mund të përmbushin plotësisht kërkesën për energji në sektorin e transportit. Karburantet alternative me karbon të ulët duhet të zëvendësojnë gradualisht lëndët djegëse fosile për sigurimin e qëndrueshmërisë e transportit në afat të gjatë.

## **Ngrohja dhe ftohja**

Në shkurt të vitit 2016, Komisioni propozoi një strategji të BE-së për ngrohje dhe ftohje. Ky është një hap i parë në shqyrtimin e çështjeve dhe sfidave në këtë sektor dhe zgjidhjen e tyre me politikat energjetike të BE.

Nënelementet kryesore që përfshihen:

- Prerja e energjisë së konsumuar nga ngrohja dhe ftohja mund të arrihet përmes rritjes së përdorimit të teknikave të avancuara të ndërtimit/projektimit dhe materialeve të izolimit me performancë të lartë gjatë rinovimit të ndërtesave
- Përdorimi i energjisë mund të pritet duke siguruar informacion më të mirë dhe kontrollin e përdorimit të energjisë me termostate inteligjente
- Kthimi i ngrohjes kur arrihet temperatura e caktuar, ose edhe të fiket kur nuk ka njeri në ndërtesë, në veçanti ndërtesa zyre.
- Energjia mund të shpëtohet duke përmirësuar pajisjet e ngrohjes dhe ftohjes si kaldaja në teknologjitë më të fundit dhe më efikase. Teknologjitë e tjera të rinovueshme të ngrohjes dhe ftohjes si kaldaja e biomasës dhe sistemet e ngrohjes diellore prishin përdorimin e lëndëve djegëse fosile

Në industri, energjia për ngrohje dhe ftohje mund të ruhet me teknologji efikase për energji, të tilla si njësitë e kombinuara të nxehtësisë dhe të energjisë që prodhojnë të dyja energjitë e ngrohjes dhe të energjisë elektrike dhe nëpërmjet zgjidhjeve dhe teknologjive të menaxhimit të energjisë.

## Projektligji i propozuar

Një kornizë e re ligjore ka qenë e domosdoshme për një kohë të gjatë dhe duhet të jetë e qartë që për Institutin për Politika Zhvillimore, ky projektligj përbën një hap shumë të rëndësishëm përpara. Së paku që nga viti 2012, INDEP bashkë me partnerët e tjerë të Konsorciumit Kosovar të Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), ka kërkuar ndryshime ligjore që do të mundësonin krijimin e Fondit të Eficiencës, eficiencës në prokurimin publik etj. Futja e këtyre elementeve në ligj përbën një moment shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe për vënjen e Kosovës në binarë të përmbushjes së obligimeve ndërkombëtare.

Si edhe çdo kornizë tjetër ligjore edhe Projektligji i propozuar ka disa mangësi që po të adresohen, e kompletojnë edhe më tutje projektligjin. Për shumë çështje po të kishte një memorandum shpjegues të detajuar, Komisioni dhe edhe ne si palë të treta do ta kishim punën shumë më të lehtë. Sidoqoftë, pas analizës nen për nen ne kemi vërejtur një numër ndryshimesh të cilat konsiderojmë se janë të nevojshme të bëhen në mënyrë që ligji të ketë edhe zbatueshmëri më të mirë por përfundimisht edhe efekt më të madh në mbërritjen e caqeve të eficiencës dhe në promovimin e saj si mjet për zhvillim ekonomik, mbrojtje të mjedisit dhe avancim të Kosovës në BE.

Ndryshimet që ne kemi propozuar përfshijnë qartësim të disa dispozitave ligjore, shkurtim apo ndryshim të disa afateve dhe propozime të tjera me qëllim të përmirësimit të bazës ligjore dhe ofrimit të opsioneve më të mira për maksimizimin e efekteve dhe përfitimeve më të mira nga eficientia e energjisë.

Në vazhdim është një listë e propozimeve që INDEP ka për amendamentimin e Projektligjit për Eficiencën e Energjisë:



Projektligji	Propozimi i INDEP
<p>Neni 4 Objektivat nacionale caqet dhe masat politike në fushën e efijencës së energjisë</p>	<p>INDEP propozon shtimin e një paragrafi të ri 2.11 me këtë përmbajtje: Promovimin e vlerësimit të potencialeve të Kosovës të kogenerimit dhe ngrohjes qendrore. Kjo është një nga elementet e legjislacionit aktual evropian në fushën e efijencës që duhet trajtuar dhe Kosova në këtë fushë veç ka zhvlluar projekte por është me rëndësi që kogenerimi të futet edhe në Ligjin e Efijencës pasi ndikon drejtëpërdrejtë në përdorimin eficient të burimeve të energjisë. Për më tepër, kogenerimi është trajtuar me nenin 19 të Projektligjit.</p>
<p>Neni 6 Planet Komunale të Veprimit për Efijencë të Energjisë, zbatimi dhe raportimi</p> <p>1. Duke filluar nga 15 maji i vitit 2018 për çdo tri (3) vite, komunat përgatisin dhe dorëzojnë në AKEEdraft-planet komunale të veprimit për efijencë të energjisë, të cilat do të përfshijnë politikat e propozuara të efijencës së energjisë dhe masat për përmirësimin e efijencës së energjisë, të cilat mbulojnë të gjithë sektorët që funksionojnë në nivel komunal.</p> <p>2. Para miratimit të Planit Komunal të Veprimit për Efijencë të Energjisë nga Kuvendi Komunal, AKEE do të vlerësojë përputhshmërinë e tij me politikat kombëtare të efijencës së energjisë, caqet dhe planet përkatëse dhe ta japë opinionin me rekomandime, brenda 60 ditësh nga data e parashtrimit të draft-planit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Miratimi i Planeve Komunale të Veprimit për Efijencë të Energjisë nga Kuvendi Komunal duhet të bëhet para datës 30 nëntor të vitit përkatës dhe i njëjti duhet të mbulojë tri (3) vitet në vijim.</p>	<p>INDEP propozon që shprehja: "Duke filluar nga 15 maji I vitit 2018" në nenin 6 paragrafi 1 të zëvendësohet me shprehjen: "Duke filluar nga 15 shtatori I vitit 2018". Afati vijues në paragrafin 2 të nenit 6, "para datës 30 nëntor" të zëvendësohet me "para datës 15 shtatori". INDEP, nga përvoja e monitorimit, konsideron që komunat duhet të miratojnë më heret sesa në fundvit planet e veprimit në mënyrë që të kenë kohën e mjaftueshme për t'u përgatitur për zbatimin e tyre në vitin dhe vitet vijuese. Hapësira maj-nëntorë është shumë e gjatë.</p>
<p>NENI 8, paragrafi 7: Deri më 31 Korrik 2018, AKEE, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e ndërtesave publike, përgatit dhe do të bëjë publik një inventar të ndërtesave të institucioneve qeveritare të nivelit qendror nga paragrafi 2 i këtij neni duke mos përfshirë ndërtesat nga paragrafi 4 i këtij neni. Ky inventar duhet të përmbajë së paku të dhënat si në vijim</p>	<p>Nëse AKEE nuk ka hartuar dhe nuk e ka bërë publik këtë plan, data 31 korrik 2018 duhet zëvendësuar me 31 korrik 2019. Nëse kjo ka ndodhur tashmë, INDEP konsideron që kjo pikë duhet hequr.</p>

<p>Neni 9 Blerja nga organet publike 1. Autoritetet dhe organet e administratës qendrore dhe lokale, si dhe të gjitha autoritetet ose subjektet tjera publike që zbatojnë Ligjin për Prokurimin Publik dhe ose FKKE, do të blejnë vetëm produkte, shërbime dhe ndërtesa me performancë të lartë të efijencës së energjisë, me kusht që ato janë në përputhje me kosto-efektivitetin, fizibilitetin ekonomik, qëndrueshmërinë e përgjithshme, përshtatshmërinë teknike, si dhe konkurrencën e mjaftueshme, në pajtim me Udhëzimin Administrativ sipas paragrafit 1.3 të nenit 42 të këtij ligji.</p>	<p>INDEP propozon heqjen e pjesës së fjalisë: "me kusht që ato janë në përputhje me kosto-efektivitetin, fizibilitetin ekonomik, qëndrueshmërinë e përgjithshme, përshtatshmërinë teknike, si dhe konkurrencën e mjaftueshme" pasi investimet në efijencë kanë gjithnjë kosto-efektivitet pozitiv dhe kjo vetëm lë hapësirë për organizatat buxhetore që t'i shmangen zbatimit të kësaj dispozite. Për më tepër, Ligji Nr.04/L-042 i Prokurimit Publik përcakton që çmimet nuk mund të tejkalojnë vlerën e tregut dhe kjo është e mjaftueshme për të adresuar çfarëdo shqetësimi në lidhje me çmimet.</p>
<p>Neni 10 Skema obligative për efijencë të energjisë 2. Operatorët e Sistemit të Energjisë Elektrike dhe/apo energjisë termike ose kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë dhe ose shpërndarësit e lëndës djegëse të lëngshme të energjisë për shitësit me pakicë dhe ose që furnizojnë drejtpërdrejt lëndë djegëse për konsumatorët fundorë që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës sipas legjislacionit përkatës, konsiderohen Palë të Detyruara të skemës së detyrimeve të efijencës së energjisë. Nga radhët e atyre Palëve të Detyruara, Qeveria do të përcaktojë ata që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave të detyrimeve të efijencës së energjisë në përputhje me paragrafin 9 të këtij neni.</p>	<p>Direktiva 2012/27/EU është e qartë në ruajtjen e konkurrueshmërisë në treg. Fjalja e fundit e paragrafit: "Qeveria do të përcaktojë ata që do të kontribuojnë..." I jep të drejtë Qeverisë të përjashtojë nga skema obligative ndonjë operatorë të sistemit të energjisë apo kompani në treg. INDEP propozon që të heqet fare kjo fjali duke pasë parasysh se paragrafi 1 i të njëjtit nen përcakton Ministrinë si autoritetin që harton skemën. Duhet pasur shumë kujdesë në hartimin e skemës dhe INDEP dëshiron të vë theksin tek një shpërndarje e drejtë e obligimit sepse mund të ndodhë që duke qenë se kursimi kumulativ nuk preket, Qeveria mund të favorizoj ndërmarrje të caktuara në dëm të tjerave.</p>
<p>Neni 16 Matja</p>	<p>INDEP konsideron që ky nen përbën një hap shumë të mirë në rritjen e efijencës së energjisë. Mirëpo, në formën e tanishme, vendosja e matësve inteligjent është lënë vetëm si dëshirë dhe përcaktim projektues dhe nuk janë vënë detyrime të qarta ligjore. INDEP propozon që tek nënparagrafi 1.1. i paragrafit 1 të nenit 16 të hiqet pjesa pas fjalisë "matësi ekzistues zëvendësohet"</p> <p>INDEP propozon që pas paragrafit 3, të shtohet një paragraf I ri me këtë përmbajtje: "Zyra e Rregullatorit për Energji, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, priorizon vendosjen e matësve inteligjent në Planin Zhvillimor të Operatorët në Treg të Sistemit të Shpërndarjes dhe punon ngusht me ta në realizimin e këtyre investimeve".</p>
<p>Neni 21 Etiketimi i Energjisë</p>	<p>Etiketimi I Energjisë është po ashtu një nga elementet që e bëjnë këtë projektligj mjaftë të rëndësishëm. Etiketimi I pajisjeve dhe produkteve</p>

	<p>në treg është tejet I rëndësishëm për të rritur vetëdijësimin e qytetarëve mbi pajisje të caktuara. Megjithatë, INDEP konsideron që kjo duhet shoqëruar edhe me masa stimuluese për prodhuesit, importuesit dhe shitësit e pajisjeve eficiente. INDEP propozon që pas paragrafit 7, të shtohet edhe një paragraf 8 me këtë përmbajtje: "Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, harton një udhëzim administrativ mbi lehtësirat financiare për produktet me efikasitet të lartë të energjisë." Kjo masë ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve eficiente dhe dekurajimin e përdorimit të produkteve joeficiente. Përfundimisht, ndikon drejtpërdrejtë në uljen e konsumit sidomos atë shtëpiak.</p>
<p><b>Neni 31</b>  <b>Drejtor Menaxhues 2. Drejtori Menaxhues i FKEE do të ketë së paku titull universitar në ekonomi, administrim biznesi, inxhinieri apo disiplina të ngjashme që ndërlidhen me veprimtarinë e FKEE dhe së paku 5 vite përvojë pune në financa dhe/ose menaxhment. Ai/ajo duhet ta njohë rrjedhshëm gjuhët zyrtare dhe angleze.</b></p>	<p>Në nenin 31, paragrafi 2, INDEP propozon që të ketë kriteret më të mëdha për Drejtorin Menaxhues. Këtu po flasim për një pozitë mjaftë të lartë në një institucion që do të jetë përgjegjës për financimin e aktiviteteve në fushën e efikasitetit të energjisë dhe jo vetëm. Në anën tjetër, Kosova, 18 vite pas luftës, ka krijuar kuadro të mjaftueshme dhe dalëngadalë ne konsiderojmë që duhet rritur kriteret. INDEP propozon dy ndërhyrje në këtë paragraf: "së paku titull universitar" të zëvendësohet me "së paku titull Master" dhe "së paku 5 vite përvojë pune" të zëvendësohet me "së paku 10 vite përvojë pune". Për të dy këto kriteret, Kosova nuk ka mungesë kuadrosh.</p>

INDEP përshëndetë punën e grupit punues për Projektligjin për Efikasitetin e Energjisë dhe konsideron që amendamentet e propozuara nga Komisioni deri më tani do t'i kontribuojnë përmirësimit të propozimit. Tek disa prej tyre kemi pasur disa shtesa që i propozojmë apo edhe mendime ndryshe të cilat i kemi komentuar në vazhdim:

## Amendamentet e Komisionit

Amendamenti i Komisionit	INDEP
<p><b>Amendamenti 1</b></p> <p>Neni 1, paragrafi 4, riformulohet si në vijim:  <b>4. Ky Ligj siguron gjithashtu bazën ligjore për transpozimin e legjislacionit që ndërlidhet me kornizën e etiketimit të energjisë për produktet e ndërlidhura me energjinë.</b></p>	<p>INDEP përkrahë amendamentin me përjashtim të shprehjes "etiketim të energjis" të cilën propozojmë të zëvendësohet me shprehjen "etiketim të performancës energjetike" në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa</p>
<p><b>Amendamenti 13</b></p> <p>Neni 6, paragrafi 1, afati "15 maji i vitit 2018: zëvendësohet me "15 maji i vitit 2019".</p>	<p>Duke përkrahur amendamentin e 13, INDEP propozon që periudha 15 maj 2019 të zëvendësohet me 1 janar 2019.</p>
<p><b>Amendamenti 14</b></p> <p>Neni 7, paragrafi 1, afati "30 qershor 2018", zëvendësohet me "30 qershor 2019".</p>	<p>Duke përkrahur amendamentin e 14, INDEP konsideron që afati deri më 30 qershor 2018 është I vonë dhe propozon të zëvendësohet me 31 mars 2019.</p>
<p><b>Amandamenti 33</b></p> <p>Nenit 38, i shtohet paragrafi i ri 2. si në vijim:  <b>2. Ministria përgjegjëse për energji dhe Ministria përgjegjëse për financa, do të sigurojnë dhe do të ruajnë qëndrueshmërinë financiare të fondit. Kjo do të përfshijë të paktën mbulimin e shpenzimeve vjetore të funksionimit të Fondit, si dhe sigurimin e rritjes së nevojshme të kapitalit punues të fondit, nga buxheti i shtetit dhe/ose në bashkëpunim me IFN-të dhe donatorët, në mënyrë që Fondi të jetë në gjendje të realizojë programet dhe planet vjetore të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.</b></p>	<p>INDEP konsideron që amendamenti 33 duhet hequr pasi është detyrë e bordit të Fondit që të zhvilloj politika që sigurojnë vetëqëndrueshmërinë e fondit. Vetëm përmes politikave kreative të vetëqëndrueshmërisë, fondi do të garantoj se do të përvojë mesazhin se efiçienca është fitim. Tarifat e parapara me nenin 39 janë pikërisht që Fondit ti sigurohet një qëndrueshmëri financiare.</p>

## Përfundime

Projektligji për Eficiencën e Energjisë, edhe pse është vonuar jashtëzakonisht shumë përbën një progres në bazën ligjore të Kosovës dhe në përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian. Në njërin anë, ligji parashikon krijimin e Fondit për Eficiencën e Energjisë si një mekanizëm financiar jashtëzakonisht i rëndësishëm, e në anën tjetër edhe paraqet të reja të tjera si skema obligative, auditimet, eskot etj., që kompletojnë kornizën ligjore të Kosovës në fushën e eficiencës së energjisë.

Si edhe në pothuaj çdo nismë ligjore, Qeveria nuk ka marrur mundin për të hartuar një Memorandum Shpjegues Kualitativ. Megjithatë, duke qenë se një kohë të gjatë kemi avokuar për shumicën prej ndryshimeve që ka sjellë projektligji, ishim të vetëdijshëm mbi rëndësinë dhe qëllimet e dispozitave të tij. Si edhe herat e kaluara, INDEP sërish i bënë thirrje Qeverisë të ofrojë sa më tepër të dhëna në memorandum shpjeguese dhe t'i pajis deputetët me analizën kost-benefit kur është e nevojshme edhe për dispozita veç e veç.

Investimi në eficiencë është fitim. Këtë postulat e kemi përsëritur me vite të tëra. Pr këtë, INDEP mbështetë krijimin e Fondit të Eficiencës si një entitet të ndarë dhe si një organizatë jashtëbuxhetore me pavarësi të plotë të operimit dhe vetëqëndrueshmëri. Vetëm duke qenë në gjendje të vë në funksion mekanizma financiar dhe jofinanciar, ky fond do të mund të realizoj objektivat finale të ekzistimit të tij. Në këtë kuptim dhe duke njohur rolin e jashtëzakonshëm që ky Fond ka, ne propozojmë fuqizim të kriterëve të zgjedhjes së Drejtorit Menaxhues dhe anëtarëve të Bordit të Fondit. Në të njëjtën kohë, përkrahim parimet e funksionimit transparent dhe llogaridhënës të këtij institucioni.

Eficienca është termocentrali më i mirë që Kosova ende nuk e ka vënë në funksion. Investimet në ndërtesa publike dhe private dhe fuqizimi i kodit të ndërtimit në pjesën e eficiencës janë të një rëndësie jetike për të garantuar mbërritjen e caqeve të Kosovës. Në të njëjtën kohë, investimi në projekte të kogjenerimit dhe ngrohjeve qendrore ndikon drejtëpërdrejtë në përmirësimin e intensitetit energjetik dhe uljes së konsumit duke përmirësuar kualitetin e jetës në të njëjtën kohë.

Përfundimisht, Projektligji për Eficiencë është një hap përpara në kompletimin e bazës ligjore dhe në ofrimin e infrastrukturës që institucionet publike qendrore dhe lokale, bizneset dhe shoqëria në përgjithësi të mund të realizojnë potencialin e madh që gjendet në eficiencë. Zbatimi i këtij ligji do të jetë pjesa më e rëndësishme dhe më sfiduese në zhvillimin e mbarë sektorit. INDEP do të vazhdoj të mbështesë komisionin parlamentar në nismat për monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe në çfarëdo nisme që avancojnë eficiencën e energjisë, e me këtë, pa dyshim, edhe interesin publik.

---

"Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)."